



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:088455
Datë: 01.11.2021
Numri i dokumentit: 02342319

PKR.nr.74/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes trupit gjykues Sabedin Mushica-kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve Agim Ademi dhe Naser Maliqi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N. M. nga fshati Berivojcë, Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës)¹, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat Arsim Vranovci nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.91/2020 të datës 24.09.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik me datë 30.09.2021, i shpallur më datë 05.10.2021, ndërsa i përpiluar me datë 01.11.2021, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N. M., nga babai F., nëna E., e lindur K., i lindur më dt..... në Kostadincë, me vendbanim në fshatin Berivojcë, Komuna e Kamenicës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i ve- baba i tre fëmijve, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25.07.2020 rreth orës 12:00, në shtëpin e tyre të përbashkët në fshatin Berivojcë, Komuna e Kamenicës, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme familjare, i akuzuari me dashje e ka privuar nga jeta anëtarin e familjes, bashkëshorten e tij tani të ndjerën S. M., në atë mënyrë që fillimisht janë fjalosur e më pasë i akuzuari me një mjetë të përshtatshëm – shufër metalike me gjatësi prej 73cm dhe trashësi 2.2 cm, e godet tani të ndjerën S. M. fillimisht në parakrahun e dorës së majtë dhe një herë në anën e majtë të kokës e cila rrëzohet për tokë – dysheme, ashtu që edhe pasi që e ndjera rrëzohet në tokë – dysheme i akuzuari përsëri ka vazhduar ta godet me shufër metalike të dëmtuarën disa herë në kokë dhe

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr. 06/L-074, i datës 23 nëntor 2018, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019.

pjesë tjera të trupit, duke i shkaktuar plagë të hapura në kokë, thyerje në anën e majtë të kafkës së kokës të cilat plagë kanë qenë vdekjeprurëse, në këtë mënyrë tani të ndjerën – bashkëshorten e tij e ka privuar nga jeta.

-Me çka ka kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 paragrafi 1 nënparag 1.3 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe 79 të KPRK-ës dhe neneve 115, 365, 453 dhe 463 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-ës)², të akuzurin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25(njëzet e pesë) viteve, të cilin dënim do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit N. M., i vazhdohet paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar.

Të akuzuarit të lartcekur, koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.07.2020 deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, do t'ju llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Pala e dëmtuar E. R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Konform nenit 115 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 lidhur me paragrafi 1 të KPP-së, të akuzuarit të lartcekur I KONFISKOHET, shufra metalike, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale të lartcekur.

DETYROHET i akuzuari N. M., që kësaj gjykate t'i paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale përkitazi me ekspertizën psikiatrike në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, shumën prej 500€(pesqindë)Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100€(njëqind)euro si dhe shumën prej 50€(pesëdhjet)euro, për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Hyrje në arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me datë 24.09.2020, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën PP.I.nr.91/2020 të datës 24.09.2020, ndaj të akuzuarit N. M. nga fshati Berivojcë, Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.42/2021 i datës 24.02.2021, është aprovuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit N. M. dhe është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.105/2020 i datës 04.12.2020, dhe i është kthyer të njëjtës gjykatë për rivendosje me udhëzimet siç janë përshkruar në këtë aktvendim.

Me urdhërin për ekzaminim psikiatrik të kësaj gjykate PKR.nr.74/2021 i datës 16.04.2021, është urdhëruar Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, që të bëjë ekzaminimin psikiatrik për të akuzuarin N. M..

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të cilat seanca të shqyrtimit gjyqësor kanë vazhduar deri më datë 30.09.2021, në të cilin kanë prezantuar prokurori i prokurorisë Themelore në Gjilan, i cila gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë në bazë të ligjit.

Përfaqësuesi i ZMNV-ës, gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të aktakuzës dhe se në emër të të dëmtuarit do të paraqesin kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari E. R. ka deklaruar se i'a ka lën gjykatës që të vendos, ndërsa kërkesë pasurore juridike do të paraqet.

Mbrojtësit i të akuzuarit N. M., Av. Arsim Vranovci, gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ka kundërshtuar pjesën e aktakuzës së prokurorisë me arsyetimin se nuk ka arritur ta vërtetojë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale me dashje dhe se i akuzuari të dënohet për veprën penale, por jo që veprën penale e ka kryer me dashje.

I akuzuari N. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar e mbështet deklarinimin e mbrojtësit të tij duke shtuar se kërkon falje, është penduar thellë dhe i ka propozuar gjykatës që t'ia shqipton një dënim sa më të butë.

Trupi gjykues me aktvendim procedural të datës 28.05.2021, ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të akuzuarit, që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen Qerime Reka, Nazife Reka, Emine Mavrovqani dhe Fahrije Mavrovqani.

Trupi gjykues me aktvendim procedural të datës 21.09.2021, ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit që mos të dëgjohet dëshmitarja Q. R., për shkak të gjendjes shëndetësore të saj, ashtu që aktvendimi procedural i datës 28.05.2021, është revokuar sa i përket kësaj dëshmitares.

Poashtu me aktvendim procedural trupi gjykues si pas leximit të aktakuzës dhe deklarinimit të të akuzuarit të lartcekur në mbrojtjen e tij e ka refuzuar pranimin e fajësisë, për arsye se pranimi i fajësisë nuk ka qenë i plotë nga ana e të akuzuarit, andaj edhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me rrjedhën normale të procedurës.

Provat e administruara – personale dhe materiale

- Lexohen si provë raportet e zyrtarëve policor të dt.25.07.2020.
- Lexohet raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes me fotodokumentacion i dt.25.07.2020 .
- Lexohet çertifikata e martesës ndërmjet tani të akuzuarit N. M. dhe tani të ndjeres S. M..
- Lexohen çertifikatat e lindjes së fëmive të mitur S. M., S. M. dhe Z. M..
- Lexohet raporti mjekësor i QKMF në Kamenicë i dt.25.07.2020, mbi konstatimin e vdekjes së tani të ndjeres S. M..
- Lexohet raporti i autopsisë me nr.MA20-207.
- Lexohet raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor i të akuzuarit N. M. i hartuar i IPFK i dt.07.06.2021.
- Lexohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.210/17 i dt.03.10.2018.
- Lexohet aktgjykimi me nr.P.nr.84/2013 i dt.07.10.2014 i plotfuqishëm më dt.31.10.2014.
- Deklarata e dëshmitarit E. R. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021.
- Deklarata e dëshmitarit B. M. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021.
- Deklarata e dëshmitarit R. M. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021.
- Deklarata e dëshmitarit E. M. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021.
- Deklarata e dëshmitarës N. R. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021.
- Deklarata e dëshmitarës F. M. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 21.09.2021.
- Dëgjimi i ekspertës psikiatrike V. B. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 21.09.2021.

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit E. R. në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.07.2021, në mes tjerash ka deklaruar se motra e tij tani e ndjerë S. ka qenë e martuar me N. rreth pesë viteve dhe nga ajo martesë i kanë patur tre fëmijë, ku qika e madhe i ka patur katër vite, e dyta, dy vite, ndërsa djali rreth gjashtë javë, e ndjera shpesh ka shkuar tek familja e saj në fshatin Korbliq, poashtu edhe këta kanë shkuar, duke përfshirë nënën, motrën Nazife, por ka patur raste që ka shkuar edhe me mixhën. Të ndjerën e kanë dhënë me mësit në Kamenicë, kur ka shkuar në vizitë për herë të parë tek tani e ndjera, e njejtja ka qenë duke jetuar me familjarët e N., në ndërkohë kanë ndërruar vendbanim dhe kanë jetuar në Kamenicë dhe sa e dinë H. K. ia ka ndërtuar shtëpinë, rreth një vit e gjysmë para se me ndodh ngjarja. N. më rrall ka shkuar në vizitë tek familja e të ndjerës, ndërsa B., vëllau i N. më shpesh e ka sjellur S. tek ne dhe beson

se për shkak të veturës që e ka patur. Nuk e ka ditur që S. dhe N. kanë patur mosmarrëveshje në mes veti, mirëpo në gjykatë ka kuptuar se N. dhe S. kishin patur rast në polici, poashtu motra dhe nëna e kishin ditur se e kanë pasur atë rast në polici S. dhe N., ndërsa anëtarët e tjerë të familjes nuk e kanë ditur që të njëjtit e kanë patur këtë rast në polici. Kur S. e ka lindur fëmijun e tretë e njëjta e ka lindur me operacion dhe ky e ka marrë nënën dhe motrën N. ku i ka dërguar te shtëpia për ti ndihmuar S., për shkak se njëjta nuk ka mundur as kundrat e veta mi mbathë, ka dëgjuar që kunati, B. e ka dërguar te mjeku si dhe ka shkuar vet tek mjeku me taxi, ndërsa nuk e din që N. ta ketë dërguar të ndjerën tek mjeku pas lindjes së fëmijut të tretë. Ka patur kontakte të shpeshta nëpërmjet telefonit dhe i njëjti asnjëherë nuk i ka treguar se ka mosmarrëveshje me motrën e tij, tani të ndjerën. Po ashtu me vëllezërit e N., B. dhe R. e ka patur të njëjtin komunikim, ashtu që me B. para 6 – 7 dite para se me ndodhur rasti, S. ka qenë tek familja e saj, ka ardhur i njëjti e ka marrë pas orës 09:00 të natës dhe S. me fëmijë e ka dërguar prej shtëpisë deri te shkolla, nga se kerri nuk ka dalur aty për shkak të rrugës. Para se me ndodhë rasti atë ditë rreth orës 11:00, e ndjera S., ka kërkuar që me thirrë ky në telefon, mirëpo nuk ka patur valë në telefon për shkak se ka qenë në mal, ashtu që e ka thirrë qikën e vëllaut I. R., ku i ka thënë “kur të vjen baci prej malit ne të më thirrë” dhe kur ka ardhur në shtëpi, B., te vëllau Z. i ka dërguar një SMS dhe e ka njoftuar për rastin që ka ndodhur tek S., ku vëllau është qar dhe i ka thënë hajde shkojmë te motra, poashtu atë ditë kanë patur për ta dërguar motrën N. për ti ndihmuar S., ku vëllau i ka njoftuar se ka vdekë S. dhe i ka thënë hajde shkojmë, ky i ka thënë jo, ka kuptuar se të njëjtën prej Gjilanit e kanë dërguar në spital në Prishtinë, ku ka shkuar me vëllaun dhe me dy dhondur në QKUK në Prishtinë, ashtu që para se me ndodhur rasti rreth tri javë më herët motra N. ka qenë tek S. ku ka qëndruar 5–6ditë, ku edhe i ka ndihmuar për ti pastruar teshat, më tutje ka deklaruar se motra dhe nëna e tij e kanë ditur që S. dhe N. kanë patur mosmarrëveshje në mes vete.

Dëshmitari B. M. në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.07.2021, në mes tjerash ka deklaruar se vëllau e tij N. me S. tani e ndërë kanë qenë të martuar rreth pesë vite, ku një javë kanë jetuar së bashku me antarët e familjes në fshatin Berivojcë e mandej kanë dalur dhe kanë jetuar në fshatin Magur, rreth një vit e gjysmë, pas kësaj kanë jetuar në Kamenicë tek banesat sociale, ku shoqata e H. K. ia ka ndërë një shtëpi në fshatin Berivojc dhe aty kanë jetuar 2–3 vite para se me ndodhur rasti. Nga kjo martesë i kanë patur tre fëmijë edhe ate vajza e madhe i ka patur rreth katër vite, vajza e dytë dy vite, ndërsa djali ka patur rreth një muaj e një javë. Nuk e dinë dhe nuk e kanë njoftuar se të njëjtit kanë patur raporte të këqija në mes veti dhe mosmarrëveshje, dhe në ato raste kur kanë patur nevojë për mi dërgu dikund apo për të shkuar për të blerë gjëra ushqimore ky i ka ndihmuar me veturë. Distanca në mes shtëpive është rreth 4–5km. E dinë se para se me ndodh rasti të ndjerën e ka dërguar tek vëllezërit e sajë në fshatin Kurbliq ku e ndjera e kishte djalin e vogël edhe atë pas kërkesës së N., mirëpo nuk i kujtohet se a ka qenë N. në shtëpi. Pasi e ndjera e ka lindur djalin e vogël të njëjtën nuk e ka dërguar te mjeku, mirëpo e dinë se e ka dërguar vëllau tjetër R.. Për shkak të angazhimeve që i kanë patur as ky e as N., nuk kanë shkuar shpesh tek njëri tjetri, ndërsa motra dhe nëna kanë shkuar shpesh te N. dhe sa i kujtohet që as nëna e as motra nuk e kanë përmendur që S. dhe N. kanë patur mosmarrëveshje në mes tyre. Ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja ky ka qenë në mal, N. përmes telefonit rreth orës 11:00 – 11:30 i ka thënë hajde menjëherë poshtë se S. ka vdekë mirëpo nuk e ka pyetur se qysh ka vdekë për shkak se edhe rrjeti nuk ka bërë, pas përfundimit të telefonit me të akuzuarin N., ka biseduar me vëllaun R. ku e ka njoftuar se këta dy ishin rreh dhe për atë ky ka thënë që të mos hyjnë mbrenda, nuk e dinë se për çfarë arsyeje janë rrahur, për shkak se ka qenë larg rreth 2-3orë dhe fillimisht ka shkuar tek shtëpia e vet ku aty ishin prindërit e tij, vëllau R. dhe fëmijët e N. të cilët i kishte sjellur R., dhe aty kishin qenë policia ku të njëjtit nuk e lejuan që të shkojë te shtëpia e N. dhe e kanë marrë ku e kanë dërguan në stacion. Në shtëpi pasiqë arrita unë aty kishin qenë prindërit e mi , fëmija e N. dhe vëllau R. dhe

fëmitë e N. i kishte sjellur R. dhe aty ka kuptuar se ka ndodhur një vrasje por qysh a tek nuk e dinë. Në mbrëmje nëpërmes telefonit e ka kontaktuar vëllau i S., Z. dhe më ka pyetur se çka ka ndodhur, ky i ka treguar se S. dhe N. e kanë patur një mos marrëveshje dhe S. ka vdekur. Më tutje ka deklaruar se S. nuk ka shkuar shpesh te familja e saj, në ato raste kur ka shkuar ky e ka dërguar të njëjtën dhe poashtu vëllezërit e të ndjeres nuk kanë ardhur shpeshë te e ndjera, ndërsa nëna dhe motra e tani të ndjeres kanë ardhur më shpesh te S., ku këta janë 3 vëllezër dhe që nga viti 2008-2009 janë ndarë prej bashkësisë familjare, N. nuk ka patur asnjëherë probleme shëndetësore dhe raportet në mes vëllezërve kanë qenë të mira dhe asnjëherë nuk kanë patur mosmarrëveshje, poashtu S. e as N., asnjëherë nuk janë ankuar se kanë mos marrëveshje në mes vete.

Dëshmitari R. M., në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.07.2021, në me tjerash ka deklaruar, rreth pesë vite N. me S. kanë qenë të martuar dhe kanë patur tre fëmijë, ashtu që qika e madhe i ka patur rreth katër vite, qika e dytë i ka pasur dy vite dhe djali i ka pasë një muaj e një javë, ku fillimisht të njëjtit rreth 1-4 javë kanë jetuar te prindërit, e mandej në Kamenicë, ndërsa kohën e fundit kanë jetuar në fshatin Berivojcë dhe me sa e dinë ky raportet ndërmjet tyre kanë qenë të mira. Për shkak të angazhimeve në punë, nuk ka shkuar shpesh te N., ndërsa nëna dhe motra kanë shkuar shpesh. Para se me ndodh rasti të ndjeren e ka dërguar te mjeku në kontroll në Kamenicë nuk është i sigurt se kush e ka ftuar dhe e njëjta e ka patur edhe djalin e vogël dhe asnjëherë nuk është ankuar se ka probleme me N.. S. ka shkuar te familja e saj por jo edhe shumë shpesh dhe më së shumti e ka dërguar sajë vëllau B.. Poashtu ka patur raste që kanë ardhur familjarët e S. te N., ku i ka takuar vëllaun e sajë E., nënën e S. dhe nuk e dinë se për çfarë arsye kanë ardhur aty, për ti ndihmuar apo për qejf. Motra dhe nëna ime tek N. kanë shkuar pak për qef por edhe pak mi ndihmu S.. Nuk e dinë se të njëjtit a kanë patur të paraqitur ndonjë rast në polici për shkak të mosmarrëveshjeve të tyre, tani e dinë se të njëjtit kishin pasur mosmarrëveshje. Ashtu që kur ka ndodhur rasti ky ka qenë në shtëpinë e tij, rreth mesditës N. e ka njoftuar nëpërmes telefonit ku i ka thënë hajde se ka vdekë S., ky e ka pyetur se qysh ka ndodhur, i njëjti i është përgjigjur, hajde këtu e tana të tregoj dhe së bashku me nënën e tij janë nisur për të shkuar te N. me kerr, pasi që ka arritur te shtëpia e N. dy qikat dhe N. kanë qenë në oborr, ndërsa djali i vogël ka qenë mbrenda në shtëpi ku N. hyri mbrenda dhe e sollti djalin jashtë, ku as ky e as nëna nuk kanë dalur prej kerrit dhe arsyeja pse nuk kanë hyrë mbrenda në shtëpi qëndron në atë se N. i ka treguar se S. ka vdekë dhe prej kufomave tuten, ku e ka pyetur N. se si vdiç, i njëjti i është përgjigjur se kanë bërë zhurmë dhe ka ardhur deri tek që e ka mbytur dhe se N. nuk ka qenë i gjakosur, nuk i kujtohet se çfarë gjendje emocionale ka qenë N. kur kemi arritur në vendin e ngjarjes, dukej se ka qenë i shqetësuar dhe nervoz, po ashtu dukej se ishte pak i mërzitëshëm dhe nuk u qenë si gjithë. Më tutje ka deklaruar se nuk e dinë se N. a ka qenë ndonjëherë i sëmurë dhe me sa e dinë asnjëherë nuk ka qenë në shërim. Për fëmijët përkujdesen vëllezërit dhe motrat, deri më tani familja e S. nuk i ka kërkuar fëmijët ashtu që janë të gatshëm që të ia mundësojë kontaktin me fëmijë. Kanë dërguar njerëz të vullnetit mirë për tu pajtuar, mirëpo nuk kanë pranuar dhe poashtu nuk na kanë dërguar fjalë që mos të dalim ose ti kemi borxh të njëjtëve.

Dëshmitarja N. R. në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.07.2021, në mes tjerash ka deklaruar, për afërsisht e ndjera S. ka qenë e martuar rreth 5 vite, e njëjta ka ardhur shpesh tek familja në fshatin Korbliq, S. e ka njoftuar se njëherë ka patur mosmarrëveshje me N. edhe gjatë vitit 2015 apo 2017, për shkak se N. e ka qitë shtëpinë në shtije mirëpo nuk është e sigurt për këtë. E njëjta e ka njoftuar se N. po i rreh fëmijët shumë, mirëpo nuk i ka treguar se për çfarë arsye i ka rrah, ashtu që në familjen e tyre të gjithë e kanë ditur, përpos djemëve që N. dhe S. e kanë patur problemin e shtëpisë, ndërsa për tjetër send jo. Nuk e ka ditur se S. dhe N. të kenë pasur ndonjë rast të paraqitur në polici. Tri javë para se me lind e ndjera, nëna ka qëndruar tri ditë te

ajo, ndërsa pas lindjes nëna nuk ka qenë, mirëpo kjo ka qenë ku N. së bashku me motrën e vetë ka ardhur dhe e ka marrë në Viti dhe tek shtëpia e N. ka qëndruar tri ditë, me familjarët e N. kanë shkuar e kanë marrë S. në spital pas lindjes dhe se e njehta ka patur nevojë për ndihmë, ku aty kanë qëndruar nëna, motra dhe mbesat e N. dhe i kanë ndihmuar për punët e shtëpisë. Për herë te fundit me të ndjerën ka kontaktuar ditën kritike përmes telefonit ku e njehta ka kërkuar që të sjkoj që ti ndihmojë me pastrimin e shtëpisë pasi që ishte festa e Bajramit. Më tutje ka deklaruar se N. ka ardhur tek shtëpia e familjes tonë, çdo herë kur ka ardhur edhe motra, përjashtimisht nuk ka ardhur në ato raste kur S. e ka sjellur vëllau i N. tek ne dhe se sjelljet e N. kur janë takuar kanë qenë në nivel dhe se ditën kritike kur ka kuptuar se çka ka ndodhur kjo është shokuar.

Dëshmitarja E. M. në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.07.2021, në mes tjerash ka deklaruar: me sa e dinë N. dhe S. punët mirë i kanë patur ndërmjet veti, kur ka shkuar me djalin ditën kritike për mi marr fëmijët e N. i njëjti ka qenë pak si mërzitshëm dhe dy qikat kishin qen në oborr, ndërsa pasi që kanë arritur N. ka hyrë mbrenda në shtëpi e ka marr djalin dhe e ka sjellur tek ne dhe për shkak se frigohet prej xhenazeve nuk ka hyrë fare mbrenda në shtëpi, nuk e dinë që kanë patur ndonjë rast të paraqitur në polici dhe gjykatë në mes N. dhe S.. Raportet në mes tyre kanë qenë të mira dhe nuk kanë bërë poter ndërmjet veti por S. ka qenë shumë nervoz dhe se nuk i kujtohet se N. ka qenë ndonjëherë i sëmur dhe S. me këtë është sjellur mirë.

Dëshmitarja F. M., në shqyrtimin gjyqësor të datës 21.09.2021, në mes tjerash ka deklaruar: Raportet para ngjarjes kritike në mes vëllaut N. dhe tani të ndjeres kanë qenë të mira, poashtu para se me ndodhur ngjarja nuk ka pasur kontakt me telefon me të akuzuarin, po ashtu edhe kjo i ka patur raportet e mira si me N. ashtu edhe me të ndjerën dhe në ato raste kur ka qenë aty nuk ka vërejtuar ndonjë raport jo të mirë në mes N. dhe të ndjeres, as që e kanë përmendur për raportet e N. me tani të ndjeren.N. nervoz ka qenë ka pak ,mirëpo i njëjti mirë është sjellur me neve, mirëpo nuk e dinë se i njëjti a ka qenë në tretman mjekësor mu trajtu për shkak të nervozës, po ashtu edhe e ndjera me fëmijët e saj ka patur që është bërë nervozë, mirëpo mirë është sjellur me ta .

Ekspertja psikiatër V. B., në shqyrtimin gjyqësor të datës 21.09.2021, në mes tjerash ka deklaruar: Ekzaminimi psikiatrik i N. M. është realizuar në IPFK në mënyrë spitalore nga data 18.05.2021 deri më 07.06.2021 nga ana ekspertëve, dy psikiatërve dhe një psikolog. Gjatë ekzaminimit psikiatrik është marrë për bazë :anamneza apo të dhënat të cilat i ka deklaruar vetë N., të gjitha shkresat e lëndës të sjellura nga gjykata përfshirë deklaratat dhe dinamikën e ngjarjes, ekzaminimit diagnostikuese siç janë CT dhe EEG, analizat laboratorike dhe raporti psikologjik, të gjitha këto janë përfshirë një raporti përmbledhës ku mendimi dhe konstatimi është deklaruar e ekspertëve bazuar në të gjitha të dhënat dhe gjetjet gjatë këtij ekzaminimi, përveq të dhënave anamnestike apo nga vetë N. në shkresat e lëndës kanë qenë edhe deklaratat e familjarëve të N. të cilët nuk paraqesin ndonjë të dhënë për ndonjë sëmundje eventuale në aspektin psiqik e poashtu edhe gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë psikiatrikë nuk është konstatuar ndonjë sëmundje mendore eventuale e shfaqur kohën e fundit , kjo është konstatuar edhe me CT dhe EEG (ndryshimet trurorë). Nëqoftëse vërehen ndryshimet trurorë ato nuk do të thotë se shfaqen tash për tash apo menjëherë por në mënyrë kronologjike, ekziston një periudhë kohore që eventualisht ndonjë ndryshim mund të lejë gjurmë dhe vërtetohet gjatë EEG, poashtu konstatohet me CT, ashtu që këto dyja e plotësojnë njëra tjetrën.

Përmbajtja e provave materiale

Nga raportet policore të datës 25.07.2020 gjykata ka konstatuar faktin se rreth orës 12:55, nga baza janë njoftuar se në fshatin Berivojcë, bëhet fjalë për një rast, ashtu që së bashku me koleg tjerë janë nisur dhe kanë arritur në vend të ngjarjes, ku e kanë arrestuar personin N. M. dhe kanë hyrë mbrenda në shtëpi ku kanë vërejtuar një person të gjinisë femërore e shtrirë na bark si dhe afër kokës kishte gjak, ku pas pak ka mbritur ambulanta me personelin mjekësor dhe e kanë konstatuar vdekjen e personit.

Nga raporti i vendit të ngjarjes i datës 25.07.2020, gjykata ka konstatuar faktin se pas marrjes së informatës nga njësia e krim teknikës rajonale së bashku me majorin A. U. dhe prokuorin e shtetit Arben Ismajli, janë nisur në vend të ngjarjes në fshatin Berivojcë ku edhe kanë arritur, ku nga zyrtarët tjerë policor janë njoftuar se bredna në shtëpi gjendet trupi i pa jetë i S. M., vdekjen e së cilës e ka konfirmuar mjeku kujdestar L. S., ku vrasjen dyshohet ta ketë kryer bashkëshorti i të njejtës N. M., edhe atë me një mjet të fortë-shufër metalike, ku mandej kanë filluar me ekzaminimin e vendit të ngjarjes, ku shtëpia ishte një katëshe, me koridor dy dhoma gjumi, banjo dhe një dhomë dite, fillimisht në koridor, nga dhoma e ditës në drejtim të njëres nga dhomat e gjumit dhe anasjelltas shiheshin gjurmë gjaku të shputave të këmbëve. Në mes të dhomës së ditës, me kokë në drejtim të derës shihet trupi i viktimës i shtrirë me gjokë nga dyshemeja, nën kokën e viktimës ishte një pëllgë gjaku, në dysheme, në drejtim të derës e cila ishte e hapur, në derë pjesën e jashtë dhe në mur, afër derës kishte njola gjaku. Njollat e gjakut në derë më e larta nga dyshemeja ishte 43 cm, ndërsa në mure 1.20m. Jashtë shtëpisë në oborr rreth 10m, ishte një shufër metalike me perimetër 73 cm, e gjatë dhe 2.2 e trashë, me të cilën dyshohet ta ketë goditur i dyshimit në kokë viktimën. Pasi që kanë arritur edhe ekipi i IML, e kanë ekzaminuar në mënyrë sipërfaqësore trupin e viktimës ku e kishte kafkën e thyer në anën e majtë, ku në këtë pjesë shiheshin edhe pjesë të trurit të dalë jashta dhe në dorën e majtë nën bërryl kishte një mavijosje, e që dyshohet të ketë ardhur nga goditja me shufër.

Nga foto albumi i bërë në vend të ngjarjes, gjykata ka konstatuar faktin se janë 11 foto, ku shihet shtëpia, koridori i shtëpisë me gjurmë të shputave të gjakosura, dhoma e gjumit me shputa të gjakosura, e ndjera e shtrirë në dhomë të ditës, njollat e gjakut afër kokës, në dysheme dhe në derë, shufra metalike, koka e viktimës ku shieh edhe pjesë të trurit të dakë jashtë kafkës, mavijosja në krahun e majtë të viktimës.

Nga certifikata e martesës me numër M 11036730 i datës 24.08.2020, gjykata ka konstatuar faktin se të njejtët ishin të kurorizuar me datë 30.09.2016, pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Kamenicë.

Nga ekstraktet e lindjes të këshur nga Zyra e Gjendjes Civile në Kamenicë, gjykata ka konstatuar faktin se të njejtët i kanë patur 3 fëmijë të mitur edhe atë S.M e lindur me datë 06.09.2016, S.M, e lindur me datë 04.05.2018 dhe Z.M, i lindur me datë 17.06.2020.

Nga raporti mjekësor i QKMF-Kamenicë, i datës 25.07.2021, gjykata ka konstatuar faktin se ekipa mjekësore kanë shkuar në fshatin Berivojcë, ku kanë konstatuar se kanë të bëjnë me një person pa shenja jete e gjinisë femërore e cila ishte në shtëpi brenda në dhomë, ku plaga ishte e hapur në anën e majtë të kokës me dalje të masës trunore.

Nga raporti Institutit Psikiatrik Forenzike në Prishtinë, e datës 07.06.2021, në mes tjerash gjykata ka konstatuar faktin se te i ekzaminuari nuk është gjetur çrregullim apo sëmundje mendore e kualitetit psikotik, prapambetjes mendore apo çrregullimit mendor për shkak të abuzimit me substanca psikoaktive, nuk ka histori të trajtimit në aspektin psikiatrik, ashtu që në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, nuk ka të dhëna se i njejtë ka qenë i penguar nga elemente psikike të cilat dëmtojnë aftësinë mendore që të kuptojë rëndësinë e veprës si dhe aftësinë e kontrollit të veprimeve të tij dhe kjo është e zhvilluar në mënyrën e

zhvillimit të ngjarjes pra dinamikës së ngjarjes para, gjatë dhe pas veprës. Po ashtu sa i përket raportit të vlerësimit psikologjik në mes tjerash kanë konstatuar se i akuzuari është karakterizuar me kapacitete normale intelektuale, ashtu që nga eksplorimi psikologjik i njejt nuk ka asnjë pengesë në sferën e funksioneve njohëse, proceset psikike për njohjen dhe testimin e realitetit janë të paprekura dhe se ka aftësi të mira të të kuptuarit dhe shprehjes së mendimeve dhe se nuk ka elemente ose tipare që mund të flasin për ndonjë psikopatologji të mundshme, e cila mund të pengoj ose dëmtojë aftësinë për të kuptuar lidhmërinë shkak-pasojë e ngjarjeve.

Nga raporti i autopsisë në emër të të ndjerës S. M., me numër MA20-207 i Institutit të Mjekësisë Ligjore, në mes tjerash gjykata ka konstatuar se në anën e majtë të kokës në nivel të regjionit parietal-temporal(muror-tëmthor) të majtë ndodhet një plagë shqyese, me buzë të çrregullta, e shoqëruar me thyerje të hapur të kafkës dhe me dalje të indit trunor jashtë me përmasa rreth 22x4.5 cm, në regjionin parietal të majtë , rreth 2 cm mbi plagën e përshkaruar më lart ndodhet një plagë shqyese, me buzë të çrregullta dhe me përmasa rreth 9.5x4cm, në regjionin frontal (ballor) të djathtë të kokës ndodhet një plagë shqyese rreth 4x0.5cm, në anën e djathtë të fytyrës në nivel të këndtit të jashtëm të syrit të djathtë, ndodhet një dërmishje lëkurore me përmasa 2x1cm, dëmtim i ngjashëm ndodhet edhe në nivelin e rrënjës së hundës dhe mbi vetullën e djathtë, në nivelin e kapakut të sipërm të syrit të majtë ndodhet një hematomë e shoqëruar me edemë(enjtje) të indeve të buta përreth si dhe në regjionin e parakrahut të dorës së majtë, në nivel të pjesës ulnare ndodhet një dërmishje lëkurore e cila shoqërohet me një hematomë në formë boshtore me përmasa 6x2.5cm, ku vdekja e të ndjerës S. M. është e dhunshme dhe ka ardhur si rrjedhojë e gjakderdhjes brednatrunore në të dy meisferat e trurit e shoqëruar me thyerje të kockave të përshkruara më lart, si pasojë e veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës(jo i mbretës).

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Kamenicë me numër P.nr.210/2017 i datës 03.10.2018, i plotfuqishëm me datës 03.01.2019, gjykata ka konstatuar në mes tjerash faktin se i akuzuari N. M., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, ekzekutimi i të cilit nuk do të nëhet, nëse i akuzuari mbrenda afatit prej 1 viti, nuk kryer vepër tjetër penale, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 në lidhje me nenin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, ku e dëmtuar ka qenë tani e ndjera S. M. ashtu që me një mjet të fortë-bisht të sopatës...pas një fjalosje paraprakee gjatë kohës sa ishin duke punuar në arën e tyre, e la sulmuar të ndjerën duke e goditur një herë në kokë, një herë në krahë dhe në shpindë.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Kamenicë me numër P.nr.84/2013 i datës 07.10.2014, i plotfuqishëm me datës 31.10.2014, gjykata ka konstatuar në mes tjerash faktin se i akuzuari N. M., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 ditëve, për shkak të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Pretendimet e refuzuara

Gjykata me aktvendim procedural e ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit N. M., avokat Arsim Vranovci, që të akuzuarit ti bëhet një superekspertiz psikiatrike mbi shkakun kryesor të veprimit në momentin e kryerjes së veprës penale, me arsyetimin se konstatimi i IPFK-ës, dëgjimi i ekspertës psikiatre e ka ndriqar mjaftueshëm gjendjen psikike të të akuzuarit, shtu faktin tjetër se i njejt më heret nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje psikike.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari N. M., në shqyrtimin gjyqësor të datës 21.09.2021, në mes tjerash ka deklaruar me tani të ndjeren S. kanë qenë të martuar rreth 5 vite, raportet prej fillimit të martesës e deri në ditën kritike kanë qenë të mira, ditën kritike herët në mëngjes orës 06.00, është zgjuar për të shkuar në punë në mal për të prer druajn, fëmijët u zgjuan prej gjumit dhe e ka thirrë shumë here të ndjeren S., për tu qar për për mi ja lan fëmijtë te shpija e njëjta ka qenë fjetë, edhe përkundër asaj që e ka thirrë, e njëjta nuk u është zgjuar. Ashtu që është detyruar me thirr shefin me i tregu që nuk po mund me shku në punë për shkak të fëmijëve. Pas kësaj ka dalur në oborr të shtëpisë dhe ia ka fillu me punu duke e hjekur do dhe, rreth orës 7:20, e ndjera është zgjuar nga gjumi dhe ia ka filluar me fyer, duke iu drejtuar me fjalët: pse më ke thirr mua me ma prish gjumin dhe ka përdorur fjalë të ndyra, duke më thënë se ta boj kështu, ta baj ashtu, ti thej dhëmbët, të mbyti, e njëjta më ka fyer me nënë dhe gjer në ora 10:00 ka vazhduar duke e share. Në ora 10.00 i ka marr fëmijët dhe ka shkuar mbrenda, nga se fëmijtë kanë qenë jashtë dhe e ka pyetur të ndjerën se a i ke pregaditur fëmijve bukë, e njëjta nuk i është përgjigjur, ashtu që e ka pregadita ushqimin ku edhe kanë ngrënë i ka dërguar fëmijët në dhomën e fjetjes për të fjetur dhe prapë është kthyer në kuzhinë për të pirë qaj, ku e ndjera i është drejtuar me fjalët, *“për që ma ke prishë gjumin herët kam mi thirrë vëllezërit dhe kushëritë e mij për me të rre me të ba llam”*. Konflikti ka filluar në momentin kur i ka thënë të ndjerës se kur ata arrinë në oborr ky do ti thërras policinë, dhe mandej e njëjta e ka goditur me grusht dy herë pas kokës, gjatë kohës kur është qar për të dalur jashtë edhe një herë e ka goditur me grusht pas kokës, ka dalur jashtë në oborr dhe e ka gjetur një cev të hekurit afër traktorit, ka hyrë mbrenda që ta frigojë të njejtën për me u ndal dhe ajo ishte fshehur pas derës tek salloni, kur ka hyrë mbrenda në sallon nuk e ka parë të ndjerën dhe prapë ajo e ka goditur një herë me grusht pas kokës dhe ky i është përgjigjur duke e goditur me cevin të cilin e ka patur në dorë ashtu që e ka humb kontrollën dhe nuk e dinë se ku dhe sa herë e ka goditur, vetëm kur e ka parë se e njëjta ishte e shtrirë në tokë. Ka dalur në oborr është ulur në një ulëse dhe e ka dhezur një cigare, ka tentuar me gjetë numrin e policisë mirëpo nuk e ka parë, është kthjellur pak, pastaj e ka thirrë vëllaun B. në telefon dhe i ka treguar për ngjarjen që ka ndodhur, i njëjti e ka njoftuar se është shumë larg dhe nuk mundet që të vijë, pas kësaj e ka thirr vëllaun e vogël Rexhepin i ka treguar për ngjarjen, duke i thënë merre nënën dhe hajde merri fëmijët, ashtu që fëmijët ishin fjetur, i ka zgjuar, ku i ka marrë dhe i ka vendosur jashtë në oborr, aty i kanë pritur deri sa ka ardhur vëllau, ku dy vajzat kanë hyrë mbrenda në veturë ndërsa është kthyer e ka marr djalin mbrenda dhe e ka dërgu te vetura, pasi që ata jën nisur në drejtim të shtëpisë së tyre ky është ndalur në oborr dhe nuk ka hy mbrenda , i ka thirrur policinë ku edhe i ka pritur në vendin e ngjarjes, ku pas 5-6 minutava, policia ka ardhur tek shtëpia ku edhe i ka treguar për ngjarjen që ka ndodhur. Më tutje ka deklaruar se para ngjarjes kritike kanë patur probleme me tani të ndjeren S., dhe atë pasi që kanë lindur fëmijet, dy herë kanë qenë në polici me te, ndërsa në gjykatë nuk kanë qenë, me familjen nuk ka biseduar që ka patur problem me tani të ndjeren, ndërsa vëllut të ndjeres Imris i ka treguar që kanë mosmarrëveshje, ditën kritike ka dalur prej kontrollës dhe nuk ka patur kohë se si të mendoj, e ka vërejtur se nga goditjet e njëjta ka ra në tokë dhe nuk ka lëvizur më, mirëpo nuk i kujtohet se a i ka ofruar ndihmë të njejtës, me rastin kur e ka goditur e ndjera me grusht, gjak nuk ka patur, mirëpo dhimbje po dhe se nuk i kujtohet se a e ka goditur tani të ndjeren sa ka qenë e njëjta ratë. Më përpara nuk ka ndodhur me më godit e ndjera, ndërsa ditën kritike e njëjta e ka goditur me grusht. Ashtu që është penduar thellë për veprën penale për të cilën e ka bërë dhe kërkonë falje për këtë.

I ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici me datë 25.07.2020, ku në mes tjerash ka deklaruar se *“...Pastaj është kthyer që ta pregaditë diçka për të ngrënë , bashkëshortja ka vazhduar duke e sharë dhe fyer, dhe ky i është kundërvyer duke i thënë boll ma, se sun po të durojë, dojnë me më lëshu nervat, ku pas kësaj ajo ka filluar që ta sulmojë fizikisht, duke u munduar që ta godasë , por nuk ka arritur pasi që ky është larguar, është sjellur rreth tavolinës*

në dhomë, ajo ka vrapuar pas këtij, mirëpo ky ka hypur në shtratë dhe ka dalur jashtë në oborr të shtëpisë dhe pasi që ishte në gjendje të rëndë psikike e ka gjetur një shufër metalike të cilën e ka marrur dhe ka hyrë brenda në dhomë dhe i ka thënë mos tento të më godasësh se të myti krejt, ajo me një tanir(pjatë) në dorë ka qenë te kuzhina dhe ka tentuar që ta godasë dhe në atë moment e ka goditur me atë shufër në kokë bashkëshorten e cila është rrëzuar në tokë dhe deri sa ishte në tokë e ka goditur edhe dy apo tri herë...ashtu që kur ka goditur herën e parë ajo nuk është rrëzuar për tokë dhe deri sa ka qenë në këmbë e ka goditur për herë të dytë, ajo është rrëzuar në tokë dhe e ka goditur edhe 2-3 herë herë. I akuzuari është përgjigjur se nuk i kujtohet se çka ka deklaruar në polici dhe se qëndron pranë deklaratës që e ka dhënë në prokurori ndërsa në polici nuk qëndron pranë deklaratës.

Vlerësimi dhe analizimi i provave sa i përket të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pas vlerësimit me ndërgjegje të plotë dhe profesionalizëm sipas bindjes së plotë në kuptim të nenit 361 paragrafi 1 të KPP-s, edhe atë të çdo prove veç e veç dhe të gjitha të lidhura në mes vete, duke nxjerr përfundime të drejta dhe logjike lidhur me faktet vendimtare të figurës së veprës penale lëndore, e duke vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti e ka kryer veprën penale vrasje e rëndë nga dispozitat ligjore të lartcekura, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, por se lidhur me të do të ipet arsyetim i mjaftueshëm dhe detal në tekstin e mëposhtëm të arsytimit të këtij aktgjykimi.

Nuk është kontestues fakti se i akuzuari N. M. dhe tani e ndjera S. M., kanë qenë bashkëshort në mes vete dhe nga ajo martesë i kanë tre fëmijë të mitur, dy vajza dhe një djalë.

Poashtu nuk është kontestues fakti se tani i akuzuari N. M., e ka privuar nga jeta me shufër metalik, bashkëshorten e tij, tani të ndjerën S. M. me datë 25.07.2020.

Por, trupi gjykues, ka pasur për detyrë që në këtë çështje penale të ndriçoj dy versionet e paraqitura nga palët në procedurë dhe atë: versionin e Prokurorit të shtetit, sipas aktakuzës, se i akuzuari i lartcekur e ka kryer veprën penale si në aktakuzë si dhe versionin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, se i akuzuari veprën penale e ka kryer, mirëpo jo me dashje. Andaj gjykata e ndodhur në mes këtyre versioneve arsytimitin e këtij aktgjykimi e ka përqendruar në sqarimin e këtyre rrethanave.

Gjykata pas vlerësimit të mendimit dhe konstatimit profesional të ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, nga ana e ekzaminimit të jashtëm dhe të brendshëm, të cilit edhe ia ka falur besimin e plotë, ka ardh në përfundim se ditën kritike si rezultat i goditjeve me mjet të fortë mbretës, ku në anën e majtë të kokës në nivel të regjionit parieto – temporal (muror – tëmthor) të majtë ndodhet një plagë shqyese me buzë të çrregullta e shoqëruar me thyerje të hapur të kafkës dhe me dalje të indit truror jasht me përmasa 22 x 4 .5 cm , në regjionin parietal (muror) të majtë , rreth 2 cm mbi plagën e përshkruar më lartë ndodhet një plagë shqyese me buzë të çrregullta dhe me përmasa rreth 9.5 x 4 cm e shoqëruar me gjakë mbledhje nën indet e buta , në regjionin frontal (ballor) të djathtë të kokës ndodhet një plagë shqyese me buzë të çrregullta dhe me përmasat rreth 4 x 0.5 cm , në anën e djathtë të fytyrës në nivel të këndit të jashtëm të syrit të djathtë ndodhet një gërvishje lëkurore në formë ovale dhe me përmasat 2x1cm , dëmtim i ngjajshëm ndodhet edhe në nivelin e rrënjës së hundës dhe mbi vetullën e djathtë, në nivelin e kapakut të sipërm të syrit të majtë ndodhet një hematomë (gjakë mbledhje) nën lëkuror e shoqëruar me edemë (ënjtje) të indeve të buta përreth. Në regjionin e parakrahut të dorës së majtë, në nivel të pjesës ulnare ndodhet një dërmishje lëkurore e cila shoqërohet me një hematomë (gjakmbledhje nënlëkurore), në formë boshtore me përmasa 6x2.5cm. Thyerje e hapur zhytëse multifragmentare e kafkës së regjionin parietal

(muror) të majtë me ngulitje të fragmenteve kockore në indin truror dhe me vija të frakturës (thyerjes) të cilat përhapen në drejtim të kockës parietale (murore) të djathtë, kockës temporale (tëmthore) të majtë të kockës zverkor nga prapa, duke përfshirë edhe bazën e kafkës në nivel të gropës së mesme të kafkës. Gjakderdhje masive brenda trunore në të dy hemisferat e trurit e cila përhapet dhe mbush sistemin ventrikular (barkusheve)të tij. Ku këto dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës, e ky mjet(shufër metalike) përkon me mjetin e fortë të përdorurë nga i akuzuari e i cili është gjetur nga krim teknika afër pusit (bunarit) rrespektivisht tek një grumbullë dhe në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit në fshatin Berivocjë, Komuna e Kamenicës, e cila si prova relevante gjendet në fotoalbumin e krim teknikës në foton nr. 11,12, 13 dhe 14, në faqen 7 dhe 8 të fotoalbumit dhe deri këtu ka ardhur si rezultat që të njëjtit kanë patur mosmarëveshje të vazhdueshme në mes vete. Fakti që kanë patur mosmarëveshje në mes vete, e vërtetojnë dëshmitarja Nazife Reka, e cila ka deklaruar se një herë e ka njoftuar e ndjera S., se ka patur mosmarrveshje me N. për shkak se *“N. e ka qitë shtëpinë në shitje dhe se i njëjti po i rreh fëmijët shumë”*, po ashtu vet i akuzuari e ka njoftuar gjykatën se para se me lind fëmijët nuk kanë patur mosmarëveshje, e pas lindjes së fëmijëve kanë patur mosmarëveshje, si dhe si në deklaratën e dhënë në polici dhe në prokurori vet i akuzuari ka deklaruar se kanë patur mosmarëveshje të vazhdueshme, po ashtu me aktgjykimin P.nr.210/2017 i datës 03.10.2018, i plotfuqishëm me datës 03.01.2019, i akuzuari N. M., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, ekzekutimi i të cilit nuk do të bëhet, nëse i akuzuari mbrenda afatit prej 1 viti, nuk kryen veprë tjetër penale, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 në lidhje me nenin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, ku e dëmtuar ka qenë tani e ndjera S. M. ashtu që me një mjet të fortë-bisht të sopatës...pas një fjalosje paraprake e gjatë kohës sa ishin duke punuar në arën e tyre, e ka sulmuar tani të ndjerën duke e goditur një herë në kokë, një herë në krahë dhe në shpindë. Andaj, që si rezultat i mosmarëveshjeve të vazhdueshme, në ditën kritike vet i akuzuari në deklaratën e dhënë para zyrtarëve policor, ka deklaruar se *.... ajo me një tanir(pjatë) në dorë ka qenë te kuzhina dhe ka tentuar që ta godasë dhe në atë moment e ka goditur me atë shufër në kokë bashkëshorten e cila është rrëzuar në tokë dhe deri sa ishte në tokë e ka goditur edhe dy apo tri herë...ashtu që kur ka goditur herën e parë ajo nuk është rrëzuar për tokë dhe deri sa ka qenë në këmbë e ka goditur për herë të dytë, ajo është rrëzuar në tokë dhe e ka goditur edhe 2-3 herë herë..., faktin që e ka goditur nuk e ka mohuar as vet i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor, si dhe vërtetohet nga fotoalbumi i krim teknikës me numër 5, 6, 7, 8 dhe 9 (faqet 4-7), ku po ashtu shihet tek koka e të ndjerës, pellgë gjaku, ashtu në bazë të raportit të autopsisë të përshkruar si më lartë, shihet se i akuzuari tani të ndjerën e ka goditur rreth 5-6 herë, ku shumica e goditjeve janë në pjesën e kokës dhe si rezultat i kësaj ka ardhur gjer te vdekja e të ndjerës si rrjedhojë e gjakderdhjes bredna trunore në të dy memisferat e trurit e shoqëruar me thyerje të kockave, përjashtimisht një goditje është në regjionin e parakrahut të dorës së majtë, çka rrjedhimisht për gjykatën vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari N. M. me dashje e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, po ashtu në deklaratën e dhënë në polici i akuzuari ka deklaruar ... *“ i ka thënë mos tento të më godasësh se të myti krejt“*, çka do të thot se kryesi ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tij do të shkaktohet pasoja e ndaluar mirëpo përkundër kësaj i njëjti edhe e ka dëshiruar pasojën e shkaktuar.*

Fakti se i njëjti e ka kryer veprën penale me dashje gjen mbështetje edhe në konstatimin psikiatrik të bërë nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, ku ekspertët kanë konstatuar se te i ekzaminuari-i akuzuari nuk është gjetur çrregullim apo sëmundje mendore e kualitetit psikotik, prapambetjes mendore apo çrregullimit mendor për shkak të abuzimit me substanca psikoaktive, nuk ka histori të trajtimit në apektin psikiatrik, ashtu që në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i penguar nga elemente psikike

të cilat dëmtojnë aftësinë mendore që të kuptojë rëndësinë e veprës si dhe aftësinë e kontrollit të veprimeve të tij dhe kjo është e zhvilluar në mënyrën e zhvillimit të ngjarjes pra dinamikës së ngjarjes para, gjatë dhe pas veprës, në bazë të së cilës gjykata vërtetoi se tek veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e dashjes përkatësisht elementi intelektual dhe ai volutiv ngase në bazë të këtij konstatimi siç është cekur më lartë është vërtetuar se i akuzuari i lartcekur, në kohën e kryerjes së veprës penale nuk lëngonte nga ndonjë sëmundje mendore apo çrregullim mendor dhe se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi për të kontrolluar veprimet e tij, çka pa mëdyshje vërtetohet se i njëjti ka qenë është i vetëdijshëm për veprimet e veta përkatësisht se nga veprimi i tij të shkakton edhe pasojën dhe përkundër kësaj i njëjti ka pranuar që pasoja e ndaluar të shkaktohet andaj edhe mbi bazën e të lartcekurave gjykata konsideron se është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari i lartcekur me dashje ka kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës, gjithnjë duke pasur parasysh se në veprimet e të njëjtit janë plotësuar edhe elementet e kësaj vepre penale ngase veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në privimin e personit tjetër nga jeta e në rastin konkret nga veprimi i të akuzuarit tani e ndjera është privuar nga jeta dhe se tek veprimet e të akuzuarit siç është cekur edhe më lartë është vërtetuar forma e fajit përkatësisht është vërtetuar dashja e tij për të kryer veprën penale ku edhe e ka kryer, ngase i njëjti më herët nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje psiqike, fakt ky i vërtetuar nga vet i akuzuari dhe familjarët e tij të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu edhe gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë psikiatrikë nuk është konstatuar ndonjë sëmundje mendore eventuale e shfaqur kohën e fundit, kjo është konstatuar edhe me CT dhe EEG (ndryshimet trurore), nëse vërehen ndryshimet trurore ato nuk do të thotë se shfaqen tash për tash apo menjëherë por në mënyrë kronologjike, ekziston një periudhë kohore që eventualisht ndonjë ndryshim mund të lejë gjurmë dhe vërtetohet gjatë EEG, poashtu konstatohet me CT, ashtu që këto dyja e plotësojnë njëra tjetrën, po ashtu ky fakt është vërtetuar nga eksperjta psikiatre e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor.

Në anën tjetër i akuzuari si bashkëshort i tani të ndjerës, nuk ka treguar as mëshirën më të vogël, për faktin se me të njëjtën kanë lidhur martesë dhe si rezultat i martesës i kanë tre fëmijë të mitur, fëmijët kanë qenë brenda në shtëpi, kur ka filluar që ta godasë të njëjtën dhe me rastin e goditjes e ndjera është gjakosur dhe si rezultat i kësaj njollat e gjakut kanë qenë në derë nga dyshemeja 43cm, ndërsa në murë 1.20cm, ku këto fakte vërtetohen në bazë të fotoalbumit në faqen me numër 8, 9 (faqe 5-6) dhe raportit të këyrjes në vend të ngjarjes, si rezultat i kësaj i këtyre goditjeve e ndjera ka ndërruar jetë.

Gjykata ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit të lartcekur, i cili ka deklaruar në mes tjerash “ diku rreth orës 07:20, e ndjera është zgjuar nga gjumi dhe ia ka filluar me fyer, duke iu drejtuar me fjalët: pse më ke thirr mua me ma prish gjumin dhe ka përdorur fjalë të ndyra duke i thënë se ta boj kështu, ta baj ashtu, ti thej dhëmbët, të mbyti.. ku gjer në ora 10:00 kanë vazhduar të sharat”...“Konflikti ka filluar në momentin kur i ka thënë të ndjerës se kur ata arrinë në oborr ky do ti thërras policinë, dhe mandej e njëjta e ka goditur me grusht dy herë pas kokës, gjatë kohës kur është quar për të dalur jashtë edhe një herë e ka goditur me grusht pas kokës, ka dalur jashtë në oborr dhe e ka gjetur një cev të hekurit afër traktorit, ka hyrë mbrenda që ta frigojë të njëjtën për me u ndal dhe ajo ishte fshehur pas derës tek salloni, kur ka hyrë mbrenda në sallon nuk e ka parë të ndjerën dhe prapë ajo e ka goditur një herë me grusht pas kokës”, ku e njëjta deklaratë është në kundërshtim pothuajse të plotë me deklaratën e dhënë në polici në prani të mbrojtësit, ku në mes tjerash në polici ka deklaruar se ... pas kësaj ajo ka filluar që ta sulmojë fizikisht, duke u munduar që ta godasë, por nuk ka arritur pasi që ky është larguar, ... pasi që ka hyrë brenda në dhomë i ka thënë mos tento të më godasësh se të myti krejt, ajo me një tanir(pjatë) në dorë ka qenë te kuzhina dhe ka tentuar që ta godasë..”, ashtu që

në bazë të fotalbumit askund në dyshime nuk vërehet që ka patur ndonjë pjtë, po ashtu tek pjesa e deklaratës në shqyrtimin gjyësor ku ka deklaruar “me familjen nuk ka biseduar që ka patur problem me tani të ndjeren”, ndërsa në polici ka deklaruar se “ Familja e ka ditur, por jo në detaje”, këto pjesë të deklaratës të dhënë në shqyrtimin gjyqësor gjykata nuk ia fali besimin, ngase e njehta është në kundërshtim me provat materiale dhe personale të administruara nga ana e gjykatës dhe gjykata konsideron se deklaratat e tilla të bëra nga i akuzuari i lartcekur nuk përputhen me provat materiale dhe personale të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore dhe se e gjitha kjo bëhet për ti ikur asaj, se kinse veprën penale e ka kryer jo me dashje, po ashtu nuk qëndron pretendimi i të akuzuarit që i njehti ka patur frikë për ti ndihmuar të njejtës me arsyetimin se mos po qohet e njehta edhe e godet, ngase sipas certifikatës së lindjes shihet se me datë 17.06.2020, tani e ndjera e ka lindur fëmijën e tret, kurse vepra penale ka ndodhur me datë 25.07.2020, çka do të thot se rreth 40 ditë pas lindjes, shëndeti i të ndjerës nuk ka qenë i mirë dhe se të njejtën e kanë dërguar tek mjeku vëllau i N., ka patur raste që ka shkuar edhe vet me taxi, po ashtu në shtëpi kanë shkuar për ti ndihmuar për punët e shtëpisë si motra, nëna e saj si dhe motra dhe nëna e N., çka do të thot se e njehta nuk ka patur fuqi fizike që ta godasë të njejtin ashtu sic ka deklaruar i akuzuari, dhe gjykata konsideron se një deklaram i tillë i bërë nga ana e të akuzuarit është në kundërshtim me deklaratën të cilën e ka dhënë në polici, në njëren anë dhe në anën tjetër është bërë me qëllim që t’ia letojë pozicionin e vet në procedurë.

Gjykata nuk mundi ta pranoj qëndrimin e mbrojtjes se kinse nuk janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe organi i ndjekjes nuk ka arrit që ta vërtetojë dashjen e të akuzuarit, andaj duke e pas parasysh arsyetimin e lartcekur, gjykata një mbrotje të tillë nuk e ka aprovuar, sepse e njehta nuk ka mbështetje në prova të administruara nga gjykata. Andaj, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar me prova të mjaftueshme dhe të lejueshme gjykata ka vërtetuar se përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha tiparet e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 KPRK-ës, për të cilën të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Një përfundim i tillë sa i përket elementit subjektiv rezulton nga gjendja faktike e vërtetuar me provat e administruara.

Sa i përket pjesëve të tjera të deklaratave të dëshmitarve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor edhe atë E. R., B. M., E. M., N. R. dhe F. M., gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e këtyre deklaratave për faktin se të njëjtit nuk kanë qenë dëshmitar okular si dhe gjykata i ka konsideruar si irelevante.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, trupi gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari N. M., e ka kryer veprën penale, vrasje e rëndë 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe rrjedhimisht i njëjti është përgjegjës dhe fajtor dhe se në veprimet e tij janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet

Rrethanat mbi bazën e të cilave është shqiptuar dënimi

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata për të akuzuarin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese në raport me veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë, kërkim faljen, e ka lajmëruar policinë,

ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit meqenëse i njëjti bazuar në provat e administruara në gjykata del se veprimet e tij i kishte ndërmarrë me dashje ashtu siç janë spjeguar më lartë, po ashtu i njëjti nuk është ofruar fare për të tentuar për ti ofruar ndihmë, pas kryerjes së veprës penale, apo ti thirrë shërbimet shëndetësore, si rrethanë rënduese për të akuzuarin mori edhe karakteristikat e tij personale si dhe sjelljen e mëparshme të tij, ku i njëjti me aktgjykimin P.nr.210/2017 i datës 03.10.2018, i plotfuqishëm me datën 03.01.2019, është shpallur fajtorë dhe është dënuar me dënim përkatës për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 në lidhje me nenin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, ku e dëmtuar ka qenë tani e ndjera S. M., po ashtu me aktgjykimin P.nr.84/2013 i datës 07.10.2014, i plotfuqishëm me datën 31.10.2014, i akuzuari i lartcekur është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 ditëve, për shkak të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi 1 të KPRK-ës, po ashtu si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë faktin se si rezultat i veprimeve të tij ku është shkaktuar edhe pasoja, fëmijët e mitur i ka lënë pa nënë, ashtu që të njëjtit do të rriten në mungesë së dashurisë së ofruar nga prindi, rrespektivisht nënës e cila tani është e ndjerë, si rezultat i veprimeve të të akuzuarit.

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrethanën lehtësuese por edhe rrethanat rënduese të cekura më lart është bindur se edhe me dënim me burgim prej 25 viteve mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, dënim ky i cili shpreh gjykim shoqëror për veprën penale të kualifikuar si vrasje e rëndë, ku të ndjerën e ka patur bashkëshorte, cila ka shkaktuar indinjatë në opinionin publik të përmasave të gjera të shoqërisë si tërësi, me bindje se tek i akuzuari dhe qytetarët potencial do të ngritet morali dhe forcohet detyrimi për të respektuar Kodin Penal me pjesët penale të ligjeve tjera të vendit, me të cilat mbrohen të mirat e rëndësishme juridike të qytetarëve dhe të shoqërisë s tërësi.

Në të njëjtën kohë tek i akuzuari me këtë lloj të dënimit do të rehabilitohet, duke ju kthyer jetës së tij normale private me synim të riintegritimit të tij në jetën personale, familjare dhe shoqërore, por edhe se do të parandalohet që në të ardhmen mos të kryej vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme në institucionin ku e mban dënimin dhe jashtë tij.

Vendimi mbi konfiskimin

Në kuptim të nenit 115 të KPP-ës, të njëjtit i konfiskohet shufra metalike, mjet me të cilën është kryer vepra e lartcekur penale.

Vendimi për vazhdimin e paraburgimit

Duke u bazuar në nenin 367 paragrafi 2 të KPP-ës, ku parashihet se nëse i shqiptohet dënim me burgim prej 5 vjetëve ose më shumë vjet, të akuzuarit i vazhdohet masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më gjatë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e kësaj gjykate, andaj në rastin konkret i akuzuari i lartcekur është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 viteve dhe me aktvendim të veçantë i është vazhduar masa e paraburgimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguajë në emër të shpenzimeve të procedurës penale përkitazi me ekspertizën psikiatrike në Institutin e Psikiatriisë Forenzike në Prishtinë, shumë prej 500€, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100€ si dhe shumë prej 50€, për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Vendimi mbi udhëzimin në kontetin civil

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në konstetin e rregullt juridiko civil, konform nenit 463 të KPP-ës.

Për arsyet e lartcekura u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
PKR.nr.74/2021
Me datë 01.11.2021

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi

Kryetari i trupit gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.